

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning


Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	14.08.2019
REFERENC-Ë:	18/5690/715/DMMU
PËR/ZA/TO:	"GRITANKOS" SH.P.K. Harilaq- Fushë Kosovë Fabrikë e përpunimit të lëndëve sekondare minerale në Zhur- Prizren
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Z. Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë "GRITANKOS" SH.P.K. Harilaq- Fushë Kosovë, me nr. prot. 18/5690/715/DMMU, të datës 03.10.2018.

MMPH pas shqyrtimit të kërkesës të lartcekur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, bien vendimin i cili i bashkëngjitet kësaj letërpërcjellëse së bashku me Shtojcën:

- Vendimi për refuzim të kërkesës për Leje Mjedisore për "GRITANKOS" SH.P.K. Harilaq- Fushë Kosovë, për fabrikën e përpunimit të lëndëve sekondare minerale në Zhur- Prizren.
 - Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimi Administrativ për Leje Mjedisore Nr. 07/2017.
- Me respekt



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Në bazë të nenit 31, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

Refuzim i kërkesës për Leje Mjedisore

Kompanisë "GRITANKOS" SH.P.K. Harilaq- Fushë Kosovë, për fabrikën e përpunimit të lëndëve sekondare minerale në Zhur- Prizren.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë "GRITANKOS" SH.P.K. Harilaq- Fushë Kosovë, për shfrytëzim të rërës dhe zhavorrit në ngastrat kadastrale nr. P- 71813026 - 02161-0, nr. P- 71813026 - 02162-0, nr. P- 71813026 - 02163-0, zona kadastrale Zhur- Prizren, komisioni për Leje Mjedisore pas realizimit të vizitës në terren ka kërkuar nga kompania që të plotësoj informata shtesë.

Mungojnë:


- Certifikata e përdorimit (ose Leja Ndërtimore);
- Raportin e emisioneve dhe pluhurit;
- Pluhuri total i depozituar;
- Fotot e gjendjes në terren për vendosjen e mbulojës (kulmit) mbi rezervuarin e gazit të lëngëzuar naftor (LPG-së).

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net



Pasi që kompania në fjalë nuk i ka sjell informatat shtesë të cekura me lartë, nuk janë përmbush kushtet teknike dhe mjedisore, dhe ka mungesë të dokumentacionit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, merr vendim për **Refuzimin e kërkesës për Leje Mjedisore** të kompanisë "GRITANKOS" SH.P.K. Harilaq- Fushë Kosovë, për fabrikën e përpunimit të lëndëve sekondare minerale në Zhur- Prizren.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 18/5690/ZSP/415/19 datë: 14.08.2019.

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komunës
3. DMMU-së
4. Inspektoratit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkiviot të MMPH-së


Arben CITA KU
Sekretar i Përgjithshëm

Faqe 3 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

*Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave / Department of Environment Protection and Water /
Departament za Zivotnu Sredinu i Vodu*

DATË/A:	14.08.2019
REFERENC-Ë:	18/5690/715/DMMU
PËR/ZA/TO:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	<i>100</i> Muhamet Malsiu, Drejtor i Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave <i>ketunij</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Flet përcjellëse

Bazuar në kërkesën e bërë nga kompania "GRITANKOS" SH.P.K. Harilaq- Fushë Kosovë, me nr. prot. 18/5690/715/DMMU, për tu pajisur me Leje Mjedisore, për fabrikën e përpunimit të lëndëve sekondare minerale në Zhur- Prizren, Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ujërave, ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

Me respekt,

Faqe 1 nga 1